

VENDIM
Nr.1461, datë 5.11.2008

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA,
PËR MBULIMIN E KOSTOS VENDORE , TË TVSH-SË DHE TAKSËS DOGANORE,
NË KUADËR TË PROJEKTIT “SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE SOCIALE NË
KOMUNITET”, FINANCUAR NGA IDA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në programin “Mbrojtje sociale”, t’i shtohet fondi 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë, nga i cili:

a) 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë për mbulimin e kostos vendore;
b) 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë për përballimin e TVSH-së dhe të taksës doganore.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha